



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë - Ministarstvo Trgovine i Industrije -Ministry of Trade and Industry

PROCESVERBAL

Mbledhja e Tetë

e Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik të Kosovës

E shtunë, 16 dhjetor 2017, ora 11:00

Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë, P-38

RENDI I DITËS

- 11:00-11:05 Hapja e takimit
- *Ministri i Tregtisë dhe Industrisë*
- 11:05-11:15 Fjala e Kryeministrit Haradinaj
- 11:15-11:20 Miratimi i Rendit të Ditës së Mbledhjes së Tetë të KKZHE-së
- *Ministri i Tregtisë dhe Industrisë*
- 11:20-11:40 Pako e ligjeve për ngritjen e konkurrueshmërisë së sektorit privat kosovar
- *Ministri i Tregtisë dhe Industrisë*
- *LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS*
- *LIGJI Nr. 05/L-029 PËR TATIMIN NË TË ARDHURAT E KËRPORTAVE*
- *LIGJI NR. 03/L-064 PËR FESTAT ZYRTARE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS*
- 11:40-11:45 Shkëmbimi i informatave të klientëve në mes të QRK-së dhe sektorit financiar
- *Ministri i Tregtisë dhe Industrisë*
- 11:45-11:50 Mbyllja e takimit, caktimi i datës për mbledhjen e ardhshme të KKZHE-së
- *Ministri i Tregtisë dhe Industrisë*

Hapja e takimit

Ministri Hasani:

I nderuar kryeministër, anëtarë të KKZHE-së, Ministra, anëtarë të Odave,

Mirësevini në takimin e tetë të Këshillit Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, njëherë të parin të Qeverisë së re - Haradinaj.

Besoj se jeni të informuar se Këshilli për Zhvillim Ekonomik, i kryesuar nga kryeministri z. Ramush Haradinaj, ka për qëllim të jetë një mekanizëm dialogues në sektorin publik dhe privat, i koncentruar në përmirësimin e klimës afariste në vend.

Kjo do të bëhet për të mbështetur sektorin privat, me synim zvogëlimin e papunësisë dhe rritjen e punësimin, që janë edhe një nga top prioritetet e Qeverisë së Kosovës.

Ky Këshill u votua edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, ku edhe u bënë hapat e parë të kësaj nisme, duke dërguar ligjin drejt Qeverisë dhe në Kuvend. Të gjitha këto iniciativa kishin dhe kanë për qëllim përmirësimin e kushteve të të bërit biznes dhe ofrojnë mbështetje për prodhuesit vendor, si rrjedhojë edhe rregullimin e tregut të brendshëm në vendin tonë. Në takimin e parë për këtë mandat, si koordinator i këtij këshilli do të kërkoj bashkëpunimin tuaj dhe opinione nga ju.

Tani, më lejoni të ftoj kryeministrin Haradinaj për të hapur punimet e këtij takimi dhe për të prezantuar më tepër rreth programit katër vjeçar të Qeverisë së Kosovës.

Kryeministri Haradinaj:

I nderuar Zv.Kryeministër, të nderuar kolegë Ministra, zv. Ministra, anëtarë të Këshillit Përfaqësues të Odave, është me rëndësi që kohën tuaj të çmuar ta shfrytëzojmë për veprime konkrete dhe veprime që janë në dinamikë kohore e të përputhura me planin që ka Këshilli Kombëtar për Zhvillim Ekonomik, i cili plan buron pikërisht nga akterët ekonomik.

Kjo përbërje mund t'i identifikojë të gjitha këto veprime qeverisëse, qofshin pjesë e legjislacionit ekzistues apo edhe veprime konkrete për të ardhmen, ecurinë e Zhvillimit Ekonomik dhe për gjetjen e mundësive më të mira që sipërmarrësit në Kosovë të ecin përpara.

Kryeministri Haradinaj:

Falenderon z. Erolld Belegun, i cili po bënë një punë të mirë së bashku me Besian Mustafën dhe falenderon ministrin për punën që po bënë. Dikush prej nesh duhet të kërkoj taksa zero për biznese, duhet të kërkoj grante, subvencione, përkrahje dhe dikush duhet të ketë guximin me besua se mund të ndodhë dhe kjo të bëhet një realitet i prekshëm për ndërmarrësit dhe ata që bëjnë biznes në vend.

Kryeministri Haradinaj:

Kjo punë që të bëhet, Ministria e Financave do të jetë në presionin tonë, në mënyrë që të lirohen bizneset nga ngarkesat e taksave që i bëjnë të pabarabartë me bizneset në rajon, gjersa ne duhet të krijojmë avantazhe për bizneset tona ndaj atyre të rajonit.

Ndryshe, kjo tavolinë do të kthehet në tavolinë burokratike dhe do ta humbë efektin.

Sa më përket mua, Kosova veç ka hyrë në hartën e vendeve me interes për investitorët, kjo mund të vërehet nga marrëveshjet për investime në energji, që kap shifrën e 1 miliardë e 300 milion euro.

Ky investim i huaj ka ndryshuar gjithçka dhe mos të shqetësohen prodhuesit e energjisë alternative, sepse ky investim vetëm sa i favorizon ata, vetëm e rritë këtë industri dhe nxitet pozitivisht ky zhvillim. Atëherë ta shfrytëzojmë këtë takim, keni para vetes dhe rendin e ditës dhe ligjet që lidhen direkt. Të gjithë ne duhet të jemi në një anë dhe të shtyjmë proceset, kurse Ministri i Financave duhet të jetë më i angazhuar për t'i ruajtur kalkulimet e të hyrave. Ne jemi në këtë tavolinë, që të krijojmë numra të favorshëm për sipërmarrësit, numra pa profit për t'iu mundësuar atyre zhvillim, kjo do të ishte më e frytshme, që do të duhet të dalë nga kjo tavolinë e punës.

Shumë nga ju me kanë njoftuar dhe në biseda me akterët, kam parë se e dini çfarë doni, si doni të veproni dhe të paktën të kemi afate kohore dhe të arritura nga dy takimet.

Shfrytëzoni direktivat, kohën e debatit, çka mund të jetë në favor për bizneset tona.

Nëse nuk kemi firma që thonë se kanë kushte me të mira sesa bizneset në Rajon, atëherë nuk do të jemi në nivel me vendet e tjera dhe do të jemi prapa bizneseve të Rajonit.

Ministri Hasani:

Faleminderit Kryeministër.

Shikoni agjendën para vetes, kalojmë në miratimin e rendit të ditës të mbledhjes së tetë të KKZHE-së.

Kryeministri Haradinaj:

Sa i përket rendit të ditës p.sh.: shkëmbimi i informatave mes klientëve dhe sektorit financiar a është ndryshuar kjo pikë, a janë inpute të reja apo është shkëmbim i informatave?

Ministri Hasani:

“Realisht është grupi punues i MTI-së dhe gjithë akterët që kanë marrë pjesë e kanë pa të nevojshme, që te kjo pikë të koordinohen të dhënat në mes të MTI-së dhe agjensionit civil”.

Kryeministri Haradinaj:

Nëse dikush dëshiron ta zhvillojë një ide, e cila buroi nga takimi, deri në takimet e tjera a mund të përpunohet më pas një pikë për të ndryshuar inpute të reja apo të hyrat. Është jo në rregull ta mbyllë këtë debat pa ndonjë aspekt të paraparë, mund të jetë një informatë, duke u informuar nga Ministri

Lluka. Nëse do të mund të informohemi për investimet në energji, termocentralin Kosova e Re ose ngjashëm diçka dhe do isha pro kësaj ideje.

Ministri Hasani:

“Të shtohet pika në të ndryshme kryeministër”.

Pika e parë e rendit të ditës 1. Pako e ligjeve për konkurrueshmërinë në sektorin privat kosovar.

Ministri Hasani:

Hedhë në votim dhe konsideron se aprovet rendi i ditës, pasi që nuk ka kundër.

Këtu janë paraparë tri ligje: Ligji i Punës, Ligji për Tatimet në të ardhurat e korporatave, Ligji për Festa Zyrtare. Natyrisht, ne do t'i prezantojmë tri ligjet, mirëpo ministritë e linjës mund të marrin fjalën e tyre, se si do të vazhdohet më tutje.

Vazhdojmë me Ligjin 03/L-212, Ligji i Punës.

Rekomandimi ynë ka qenë që të plotësohet dhe ndryshohet ky ligj, me të cilin do të rregullohet orari i punës prej tetë orësh, sipas marrëveshjes mes punëdhënësit, punëmarrësit dhe të sqarohet në mënyrë finale kontrata kolektive.

Për më tepër, në takimet finale u arrit një konsensus, që pushimi i lehonisë të jetë katër muaj pushim me pagesë, katër muaj pushim prindërorë me pagesë nga qeveria prej 50% dhe katër muaj pushim prindërorë pa pagesë. Për ndryshim plotësimin e këtij ligji, natyrisht, është përgjegjëse Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, me të cilën kemi menduar jo më larg se data 31.03.2018, të përfundojmë koncept dokumentin për këtë ligj.

Kryeministri Haradinaj:

Këtu duhet të flas Erolld Belegu dhe nga perspektiva të tjera të flet Ministri dhe nuk kam nevojë të kemi konferencier.

Erolld Belegu (ZKM):

Më e mira është të flet Besiani, pasi të gjitha çështjet kanë filluar të trajtohen si kërkesa nga bizneset dhe kanë ardhur si iniciativë nga bizneset jo nga Qeveria.

Në tri takimet përgatitore kemi punuar, kryesisht, në kërkesat që shumica e bizneseve kanë konsideruar që duhet të ndryshohen tek ligji i punës, kërkesa këto të cilat adresohen për një kohë e gjatë.

Besian Mustafa (KIESA):

Kryeministër, Komiteti i Biznesit ka kërkuar tri gjëra: 1) Ka qenë të rregullohet orari i punës, 2) Të sqarohet kontrata kolektive dhe 3) Pushimi i Lehonisë.

Kryeministri Haradinaj:

Ka tjetër?

Kryeministri Haradinaj:

Ministër Reçica, çka mendon ti këtu?

Ministri Reçica (MPMS):

Duhet një informacion pak më tepër z. Kryeministër, për nevojat e ndryshimit të Ligjit të Punës, praktikisht, bëhet fjalë për një ligj të ri të punës, jo për plotësim të ligjit të kaluar.

Kryeministri Haradinaj: Pse është ligj i ri?

Ministri Reçica (MPMS):

Materiali që ndryshohet prek masën në 140 nene dhe prek materien në mbi 2/3, atëherë shkohet me ligj të ri.

Kryeministri Haradinaj:

Me nxjerrë një koncept të ligjit të ri.

Ministri Reçica (MPMS): Po ne duhet të përgatisim një koncept dokument të ri në bashkëpunim me projektet e Bashkimit Evropian, ne kemi marrë pesëmbëdhjetë direktiva të Bashkimit Evropian, dhe i kemi inkorporu, të cilat lidhen me sigurinë dhe shëndetin. Ato i kemi bërë pjesë të akteve nënligjore.

Ministri Reçica (MPMS):

Ministria jonë ka përgatitë një plan veprimi, që për tre mujorin e parë deri më 30 mars të 2018, t'ia paraqesim Qeverisë koncept dokumentin për Ligjin e ri të Punës. Pas miratimit të koncept dokumentit, të kërkohet një hapësirë ligjore, e cila gjerë sa të përgatitet në tërësi ligji, që pastaj të silllet në qeveri për miratim.

Ligji mendojmë që më së largu më 30 mars do të jetë gati për miratim, ndërsa për 12 muaj do të jetë gati për miratim dhe dërgim në Kuvend.

Ministri Reçica (MPMS):

Nuk pajtohem që orari i punës të jetë problem për lehonat, duke marrë parasysh marrëveshjen për stabilizim-asociim dhe marrë për bazë neni 82 të saj. Ministria e Punës obligohet ta harmonizojë legjislacionin e saj me legjislacionin e Bashkimit Evropian.

Kryeministri Haradinaj:

A bie në konflikt me kërkesat e ndërmarrësve?

Ministri Reçica (MPMS):

Njoftoj pjesëmarrësit se këto praktika janë më të mirat në Evropë dhe këto i kanë zbatuar edhe vendet më të zhvilluara të Bashkimit Evropian, bëhet fjalë për pushimin e lehonisë për orarin e punës.

Kryeministri Haradinaj:

Nëse Ministria e Punës është hartuese e ligjit, tani ti për ta hartuar ligjin dhe për ta marrë parasysh arsyen pse po inicohet ndryshimi i ligjit e ligji po ndryshohet sipas gjitha gjasave sipas kërkesave të sipërmarrësve, a është ashtu?

Ministri Reçica (MPMS): Po ashtu është.

Kryeministri Haradinaj:

Si mund të garantohet që ky ligj nuk devijon dhe zhgënjehemi në fund?

Kryeministri Haradinaj:

Kjo po i bie që Ministri Bajram, Erolli nga zyra ime do të luftojnë për të drejtat e sipërmarrësve e ti koke me punëtorët po më doket?

Ministri Reçica (MPMS): Po, po!

Kryeministri Haradinaj:

Faleminderit shumë të gjithëve, urdhëroni.

Agim Shahini (AKB):

Falemnderit, këtu nuk paraqiten se janë mbajtur më shumë se dhjetë mbledhje të tjera, që kam qenë dhe vet pjesë e tyre, të cilat kanë filluar të organizohen nga viti 2010- 2011. Është mire të përmirësohet ky numër. Këtë kërkesë po e ripotencoj, pasi një të tillë e kam kërkuar edhe më herët, gjersa kam thënë edhe në vitin 2014 se këtu po fshihen disa mbledhje të mbajtura dhe as qeveria Mustafa, nuk e shprehu në publik se çdo gjë fillon nga ta.

Sa i përket ligjit të punës nuk ka konsensus që u paraqit në mbledhjen e fundit të Këshillit Ekonomiko Social, ne kemi iniciuar dialogun për ligjin e punës dhe jemi pajtuar ta sjellim një ligj të ri.

Kurse, tani duhet të ketë mbledhje me 18 direktiva të reja, që parashihen nga BE-ja e të futen në ligj, ku jemi pajtuar me ministrin e punës që brenda një afati tre muajsh të diskutohet me akterë dhe në fund të arrihet një konsensus.

Më duket që ligji i punës ka ardhur më herët, kjo temë është dashtë më vonë të jetë dhe është marr vendim, që pjesën kryesore ta kenë sindikatat. Ato kanë me adresuar kërkesat dhe të drejtat e punëtorëve dhe bizneset mbrojnë interesat e tjera.

Konsensusi i vetëm është që të filloi dialogu me të gjithë përfaqësuesit, ne jemi një trup i përbashkët, i cili duhet të punojë dhe të mos e shohim që kërkojmë vetëm heqjen e taksave apo të krijojmë lehtësirat për biznese, por duhet shikuar edhe interesin e shtetit, konsumatorit etj.

Temat më të lehta për t'u trajtuar duhet të trajtohen në nivele më të ulëta dhe ne duhet t'i kemi më të përafuar nga Ministria dhe këtu të vendoset pastaj për miratim apo jo.

Mendoj që ligji i punës është i rëndësishëm dhe ky ligj duket se është jo i mirë, ky ligj tash e katër vite është diskutuar se do të ndërrohet dhe qeveria juaj mirë bënë që kërkon punë operative, kjo po më pëlqen.

Kryeministri Haradinaj:

Fjala për përfaqësuesin e Odës Amerikane.

Arian Zeka (OEA):

Mosgjetyja e konsensusit ka bërë që ky ligj që është tani në fuqi nga janari i vitit 2012, të mos mund të ndryshohet tash e sa vite, pavarësisht kërkesës së vazhdueshme nga Oda Amerikane. Ne kishim takime me "Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale" dhe në takimin e fundit arritëm të kemi një konsensus me z. Belegu dhe Sekretarin e Odës Ekonomike të Kosovës. Të shkohet me idenë e z. Belegut, 'katër plus katër' - plus 'katër plus katër'. Pyetjen që partnerët më herët e bënë: Se a i konvenon bizneseve apo punëtorëve ndryshimi i këtij ligji? Unë mendoj se kjo i konvenon të dyja palëve.

Përmirësimi i pozitës së femrave pas hyrjes së këtij ligji në fuqi ka pësuar rënie të vazhdueshme dhe udhët e diskutimit për ndryshim të këtij ligji duhet të sjellin hapësirë për gratë. Më shqetëson fakti që nuk e kemi gjetë ende konsensusin, tani e pesë vite dhe konsideroj se ky Këshill nuk është gjithëpërfshirës. Kjo pasi, nuk përfaqëson të gjithë akterët ekonomik dhe Këshilli vazhdimisht ka marrë vendime të gabuara, kërkoj që diskutimet që bëhen të shtynë para vendimet.

Kryeministri Haradinaj:

Sindikatat në këtë Këshill me gjasë nuk kemi të paraparë, dikush nga odat dëshiron me fol diçka ndryshe nga kjo që u tha, risi?

I nderuar Kryeministër, unë përfaqësoj Forumin Ekonomik të Grave dhe po ashtu jemi anëtar në këtë Këshill e jo në tjera Këshille. Ai këshill është i mbyllur sa i përket çështjes së lehonisë, partnerët në Këshillin tjetër social dëshirojnë që të jetë tre muaj pushim me pagesë për lehonat. Ne nuk jemi dakorduar dhe ne me shumë organizata kemi luftuar që të paktën të jemi në katër muaj pagesë për lehonat, duke marrë parasysh ligjin për gjidhënie.

Ne pajtohemi me propozimin që është prezantuar sot, për sot kam sjellë agjendën për Zhvillim Ekonomik të Grave dhe tani nga ky raport që është alarmante çështja e jo aktiviteti i grave në punësim.

Kryeministri Haradinaj:

Mbyllim diskutimin për pikën e Ligjit të Punës, pra pikën e parë të rendit të ditës. për respekt të dy temave tjera, MPMS, merr obligim që për 3 muaj të përgatis dokumentin.

Akterët që janë anëtarë të Këshillit Ekonomik, bartin përgjegjësinë përfaqësuesit, akterët me temat që janë të hapura ende për trajtim, gjithashtu, partnerët social duhet të përfshihen në tema me sugjerimet e tyre.

Kalojmë në temën e dytë: Kush është sponzor i këtij ligji, kush e përfaqëson këtë ligj?

Besian Mustafa (KIESA):

Ligji mbi tatimin e të ardhurave të korporatave – kjo kërkesë vije nga sektori privat, Oda Ekonomike Amerikane, Këshilli i Investitorëve Evropian dhe Grupi i Prodhuesve Kosovarë. Ideja është që të riaktivizohet Bordi i pavarur i ankesave nga ATK. Pastaj ka qenë ideja që të trajtohen në mënyrë të barabartë edhe kompanitë e sigurimeve, që të mos taten 5% të mjeteve në qarkullim, por të taten 10% mbi fitimin si të gjitha kompanitë tjera në Kosovë.

Është kërkuar që të vazhdohet procesi i udhëzimit administrativ për pushimet tatimore, mirëpo me një kërkesë shtesë në si MTI që kjo të harmonizohet me ligjin për investimet strategjike të përfshihen të gjitha shpenzimet e trajtimeve të kalkulueshme të neto fitimeve të tatueshme në Kosovë. Pra të zbriten këto shpenzime sa i përket kalkulimit të tatimit.

Të zbritet tatimi në fitim për shërbimet e eksportuara në 0% , të rikujtoj se sektori i shërbimeve është i vetmi sektor me bilanc pozitiv tregtar, dhe e fundit ka qenë kërkesë -Mundësia e largimit të akcizës së brendshme të lëngjeve të gazuara dhe të pa gazuara.

Shpend Balija (KIE):

Çështjen e trajtimit të ardhurave të korporatave e kemi ngritur qysh në vitin 2015.

Kompanitë dhe investitorët e huaj në këtë rast investitorët evropian, që janë të pranishëm në Kosovë janë të diskriminuar me këtë ligj.

Ata janë të detyruar të paguajnë 5% tatim në të hyra në vend se të paguajnë 10% tatim në fitim, kjo nuk është praktikë as në Shqipëri as në Maqedoni ose rajon e lëre më në Evropë, dhe ky sektor është vetëm 3% i sektorit financiar dhe si i tillë është shumë i dëmtuar.

Ne, si përfaqësues të investitorëve evropian dëshirojmë që sa më shpejt ta ndryshojmë këtë ligj, kjo çështje është e ngritur qysh nga viti 2015 e deri më sot, prandaj ne kemi një listë të gjerë të gjërave që duhet të ngritën si prioritete në KKZHE.

Kemi kërkuar edhe nga Ministria e Financave dhe jemi dakorduar që në Janar të këtij viti të draftohet ky ligj.

Kryeministri Haradinaj:

Të kërkohet angazhimi i gjithë Këshillit dhe ligji të miratohet sa më shpejt dhe sa është punuar në këtë drejtim.

Zv. ministri i Financave – z. Fatmir Gashi:

Sa i përket këtij ligji për kompanitë e sigurimeve çështja është ngritur qysh nga viti 2004 dhe nuk është bërë asgjë në këtë drejtim, nga 7% ka rënë në 5% e prej 5% duhet të rregullohet sikur për bizneset tjera.

Ne si ministri këtë kërkesë e kemi marrë edhe nga FMN që të bëhet ndryshimi dhe barabarësia e të gjitha bizneseve, këto ndryshime janë të konceptuara dhe pritet të hyjnë në procedurë në muajin Mars, sepse në Janar do të formohet koncepti dokumenti që do të aprovohet në Kuvend dhe do të hyjë në procedurë.

Kryeministri Haradinaj:

Besian na i përmend edhe njëherë ato pesë elementet?

Besian Mustafa (KIESA):

-Riaktivizimi i Bordit të pavarur të ankesave që nuk ka të bëjë me ligjin mbi tatimin e korporatave por ka të bëjë me ligjin e ATK-së dhe do të fillojë ndryshimin e ligjit.

-Tatimi në fitim të sigurimeve është plotësisht i qartë dhe do të rregullohet.

-Udhëzimin në lidhje me lirimet e posaçme për ligjin e investimeve strategjike është duke u punuar dhe pritet të aprovohet me 30.06.2018.

-Shpenzimet e tatimit të fitimit, kalkulimit të fitimeve neto është i pranuar dhe do të inkorporohet në ligj.

-Tatimi në fitim për shpenzimet e eksportuara do të inkorporohet në ligj, kurse mundësia e shqyrtimit të ndalimit të akcizave hyn në ligjin tjetër të akcizave.

Ky trajtim për lëngjet e gazuara në këtë moment nuk mund të ndryshohet sepse është paraparë në MSA. Për këtë lloj ekziston tatimi në Evropë dhe do të shqyrtohet mundësia nëse ka hapësirë buxhetore. Deri më 30 Mars ky ligj do të miratohet në Kuvend.

Lumnije Ajdini (AKB):

Ne kërkojmë largimin e akcizës së brendshme për pijet jo alkoolike me shifër 20\02, Akciza për pijet jo alkoolike nuk bie ndesh me MSA si e potencoi më lart zv. Ministri. Ne si AKB për 8 vite kemi bërë analiza dhe kemi përcjell se prodhuesit e pijeve jo alkoolike në rajon nuk kanë akcizë as në BE por, ka vetëm Bosnja dhe Shqipëria një taksë për ambient.

Në takimet që kemi pasur jemi të habitur se si bie ndesh me MSA-në, prej kësaj analize kemi konstatuar se ka implikime buxhetore 8 deri 10 milion euro. Nëse hiqet akciza e brendshme me rregull duhet të hiqet edhe ajo e jashtme.

Kryeministri Haradinaj:

Jemi plotësisht në pajtim me këtë çështje, duke e ditur situatën me buxhetin do të interesohem ta procedoj më tutje dhe të bazohemi në mënyrën se si kanë vepruar fqinjët tanë lidhur me këtë rast.

Lumnije Ajdini (AKB):

Në këtë sektor mund të punësohen rreth 200 punëtorë, rritja e sektorit të kësaj industrie do të rritet 3% dhe buxhetit këto mjete do ti kthehen në mënyra indirekte.

Astrit Panxha (Klubi i Prodhuesve të Kosovës):

Të zbutet tatimi në fitim për eksportet të produkteve pasi që nuk është përfshirë në ligj por janë përfshirë vetëm shërbimet.

Shërbimet eksportohen më shumë se sa që importohen kështu që, nuk kanë nevojë për subvencion. Problem kemi me produktet pasi që kemi deficit tregtar dhe mendoj se më e udhës do të ishte të zbritet tatimi në fitim në sektorin e prodhimit të plastikës, riciklimit apo produkteve ushqimore që të jenë më konkurruese.

Problemi qëndron se vetëm 13% e importit mbulohet me eksport.

Hartimi i ligjit do të bëhet duke pasur parasysh kërkesat e propozuara.

Ministri Bytyqi:

Unë do të ndalem shkurt te çështja e tatimit në të ardhura të korporatave më saktësisht në aktet nën-ligjore që ndërlidhen me pushimet tatimore. Konsideroj se periudha për përfundimin e këtij udhëzimi administrativ (deri me 26 qershor) është shumë e gjatë sepse faktikisht ekziston drafti i udhëzimit administrativ dhe ka nevojë për korrigjime – ka nevojë për uljen e kriterëve sepse ato tani janë shumë të larta për të nxitë investitorët e huaj dhe duhet të lihet periudha prej maksimum tre muaj për të harmonizuar këtë me Ligjin për Investime Strategjike. Por që të thuhet se një udhëzim administrativ që veç ekziston të finalizohet për gjashtë muaj ndërsa një ligj i ri të bëhet për tre muaj konsideroj, se nuk përputhen njëra me tjetrën.

Kryeministri Haradinaj:

Faleminderit Ministër. Fjalën e ka kërkuar Zëvendës Kryeministri për Investime Strategjike. A jeni për të diskutuar këtë temë?

Zv.Kryeministri Dardan Gashi:

Në përgjithësi kur flasim për ligje edhe në debatet publike, nuk ka nevojë për të kërkuar konsensus paraprak se për këtë arsye ekziston draft-ligji, debatet publike. Ministrat e linjës duhet më shpejtë ti sjellin draft-ligjet edhe udhëzimet dhe ti qesim në debat publik.

Kryeministri Haradinaj:

Faleminderit Ministër, nëse keni të shtoni diçka konkretisht në pikën 2.3 lidhur me tatimin në të ardhurat e korporatave të lutem vazhdo – për pikat tjera i diskutojmë nesër (Zëvendës Kryeministri Gashi konfirmoi se nuk ka për të shtuar). Konstatoj se deri më 31 Janar 2018, Ministria e Financave së bashku me akterët tjerë të ulur në këtë tavolinë (Odat ekonomike, Klubin e Prodhuesve, Forumin Ekonomik të Gruas, etj.) të përgatisin Koncept Dokumentin dhe të sillen në Qeveri mirëpo nëse mbesin tema të hapura që nuk mund të zgjidhen atëherë, unë do të marrë vendim ashtu si e vlerësoj, pra, i'a propozoj Qeverisë një vendim ashtu siç e mendoj unë se është në rregull. Tash kalojmë në

pikën 3 të rendit të ditës – Ligji mbi Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës. Ky është një propozim që është iniciuar nga Erolldi prandaj e ftoj që ta bëjë një prezantim të shkurtër.

Erolld Belegu (ZKM):

Sikurse edhe propozimet tjera, edhe ky propozim vjen nga komuniteti i biznesit dhe dy herë ka shkuar deri në Parlament dhe është kthyer. Ne së bashku jemi takuar para dy ditëve edhe me Ministrin Jagxhillar dhe jemi dakorduar që ai këtë ligj shumë shpejt do ta sjell në Qeveri dhe më pastaj do të procedohet në Parlament. Ideja e këtij propozimi është që të hiqen disa festa zyrtare që të pushohet më pak dhe të punohet më shumë (racionalizimi i ditëve të festave publike dhe mosbartja e ditëve të pushimit që bien në vikende në ditët e punës gjatë javës pos festave fetare), dhe heqja e festave të 9 Majit dhe Ditës së Kushtetutës si ditë pushimi. Këto janë pak a shumë kërkesat që në vazhdimësi vijnë nga Komuniteti dhe të gjithë akterët kanë kërkuar që të hiqen por që nuk janë heqë tash 7-8 vjet.

Kryeministri Haradinaj:

Kolegë ju kisha lutë që për pjesën e mbetur të ndjekni këtë logjikë dhe Bajram (Ministri i Tregtisë dhe Industrisë) vazhdojeni ju kryesimin e këtij takimi pasi që unë po e kërkoj lejen tuaj. Vendosni afate të qarta, kritere të qarta, proces të qartë se çka po dojmë me ba sepse nuk ulem në këtë tavolinë dhe e anuloj këtë (mekanizëm) nëse vlerësoj se këtu vijmë e veç flasim e nuk bëhet puna, unë do të marrë vendim për të anuluar Këshillin Kombëtar për Zhvillim Ekonomik se mendoj se është humbje e kohës. Pra, diskutoni konkretisht tema dhe ju falënderoj për ngritjen e këtyre temave sikurse këto që u ngritën në këtë takim nga të gjithë ju. Ndëgjoni, duhet të dalim nga mjegulla që kemi hy të gjithë ne e s'po dimë me dalë, duhet të kalojmë në gjëra konkrete – unë po u'a jap rastin e negociimit të projektit “Kosova e Re” 15 vjet janë bërë krejt punët por ka ngec finalizimi dhe është shty për 2-3 vjet; 15 vjet kjo praktikë ka ndodh në Kosovë. Nëse e gjej se kush është shkaktari i këtyre shtyrjeve do të marrë masa e nuk do të ketë zhagjitje, vonesa, pallavra e teori se kemi shumë punë për të bërë e kur ti kryejmë punët atëherë mund të mbajmë sesione shkencore. Ne jemi një vend i vogël prej 2 milion banorë (sa një komunë e një qyteti të madh) dhe jemi pothuajse vend rural dhe asnjë kapacitet i yni nuk është aq aktiv dhe jemi duke fjetë pothuajse jemi ndonjë organizatë brenda Kombeve të Bashkuara. Mos u dekurajoni nga qasja ime, nuk është qëllimkeqe ndaj askujt por vetëm dëshiroj që të kryhen punët – punë që kanë pritë nga 10 vjet në tavolinë dhe kanë humb në sirtarë dhe duhet me i gjetë tash, e ju mos lejoni kështu.

Bajram, të gjitha këto tema të vendosen në konkluzat e takimit në një gjysmë faqe se nuk mund të mbahen në mend së bashku me materialet tjera. Punë të mbarë!

Ministri Hasani:

Do të vazhdojmë me punë...U propozua që festat që bien në fundjavë të mos zëvendësohen me ditë pune, u kërkua të hiqet nga kalendari i festave Dita e Kushtetutës dhe Dita e Evropës. Ne jemi të kënaqur nëse kërkesat tona të realizohen në afatin sa më të shkurtër.

Agim Shahini (AKB):

Kërkoj që të hiqen si festa zyrtare Dita e Evropës pasi që kjo ditë nuk festohet as nga vendet e Evropës. Sa i përket Ditës së Kushtetutës duhet një debat më i gjerë. Nuk duhet të bimë ndesh me të drejtat e punëtorëve por ky ligj duhet të ndryshon dhe ne si Aleancë e Biznesit e përkrahim këtë ndryshim.

Ministri Bytyqi:

Konsideroj se duhet futur në festa zyrtare edhe Dita e Alfabetit të Gjuhës Shqipe.

Arian Zeka (OEA):

Kërkoj të hiqen të gjitha festat fetare pasi numri i konfesioneve fetare në Kosovë është rritë dhe kjo do të shkaktoj festa të shumta. Sa i përket propozimit të Ministrit të Arsimit për Ditën e Alfabetit, konsideroj së është e paqëndrueshme pasi që një kërkesë të tillë mund ta bëjnë edhe komunitetet e tjera që u garantohet me kushtetutë dhe si rrjedhojë e saj ne do të bëjmë më shumë ditë pushimi se sa ditë pune. Kjo do të ishte pasqyrë jo e mirë për investitorët nga jashtë.

Ministri Hasani:

Nëse nuk ka ndonjë folës tjetër po kalojmë në pikën e radhës pasi që konsideroj se përfundoi debati rreth festave zyrtare në Republikën e Kosovës. Pika tjetër në rendin e ditës është shkëmbimi i informatave në mes të QRK-së dhe institucioneve të sektorit financiar. Kjo kërkesë ka ardhur si nevojë për përditësimin e informatave sidomos të atyre në sektorin financiar ku institucionet përkatëse ARBK(MTI) dhe ARC(MPB) janë dakorduar në parim që të nënshkruajnë një marrëveshje mirëkuptimi për ndarjen e informacioneve të kërkuara nga institucionet financiare. ARB dhe ARC në afat kohor jo më larg se 31 janar 2018 do ta nënshkruajnë këtë marrëveshje dhe njëkohësisht është kërkuar që ARBK dhe ARC të nxjerrin legjislacionin sekondar që rregullon kriteret e dhënies së qasjes në databazat përkatëse institucionale deri në afatin e përcaktuar me datë 31.03.2018. Nëse keni për të shtuar diçka Erolli dhe Besiani lidhur me këtë temë...

Besian Mustafa (KIESA):

Vetëm për të plotësuar Ministër, në takim kanë qenë edhe Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Agjencioni për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe qëllimi im ka qenë që të sigurohemi që këto marrëveshje dhe udhëzime administrative të jenë komfor me legjislacionin ekzistues. Të gjitha palët janë dakorduar që të bëhen në këtë format.

Ministri Hasani:

Faleminderit Besian, realisht janë përcaktuar afatet dhe janë dakorduar edhe institucionet përkatëse dhe pasi që ekziston një konsensus besoj se kjo do të kryhet në afatet e parapara. Kalojmë në pikën tjetër.

Sazan Ibrahimimi (AKK):

Asociacioni i Komunave të Kosovës: për hartimin e Koncept Dokumentit po marrin shumë kohë, më mirë është të kthehemi në sistemin e vjetër duke kaluar direkt në ndryshimet e ligjeve. Kam

një pyetje për Zëvendës Ministrin e Financave se në cilin stad është zhvillimi i ligjit për Partneritet Publiko-Privat. Gjithashtu, e pyes Ministrin e MTI-së se ku ka mbetë çështja e reformës së inspektoratit ku dihet që ka mbi 40 trupa inspektuese që veprojnë në Kosovë dhe besoj se me ndryshimin e këtyre ligjeve do të ketë impakt në zhvillimin ekonomik në Kosovë.

Ministri Hasani:

Sa i përket reformave të inspeksioneve jemi duke punuar në këtë drejtim dhe Koncept Dokumenti do të dërgohet shumë shpejt në Qeveri. Brenda javës ky dokument do të finalizohet dhe do të procedohet më tutje.

Zv. Ministri Gashi (MF):

Do të marrë informatë të saktë ku është paraparë dhe në çfarë niveli është ky ligj dhe në mbledhjen tjetër do ta japim si informatë.

Ministri Tahiri (MD):

Shumë shpejt do ta procedoj në Qeveri Ligjin për Gjykata. Me riorganizimin e Gjykatave në vitin 2013 Gjykata Ekonomike është shpërbërë. Nga ajo kohë kemi vetëm një Departament që merret me lëndët ekonomike – komerciale dhe biznese. Me ligjin e ri është paraparë që në 7 Gjykatat Themelore të ketë Departamente që trajtojnë çështjet ekonomike. Unë ftoj përfaqësuesit e bizneseve të jenë pjesë e debateve lidhur me këto reforma ligjore.

Ministri Hasani:

Ligjet për Procedurat Gjyqësore janë kusht për tërheqjen e investitorëve të huaj dhe është jetike bashkëpunimi me Ministrinë e Drejtësisë.

Besian Mustafa (KIESA):

Përgëzoj Ministrin Tahiri për idenë që të jenë shtatë Departamente në Gjykatat përkatëse. Në kuadër të këtij Departamenti në Prishtinë ekziston një Divizion për çështjet që ndërlidhen me investitorët e huaj, a do të bëni këtë edhe me Gjykatat tjera.

Ministri Tahiri (MD):

Do të jetë organogrami i ri dhe këto departamente do të jenë edhe në shtatë Gjykatat Themelore.

Ministri Hasani:

Propozoj që takimi i radhës të caktohet në fund të Marsit 2018 dhe me këtë e mbyllë takimin.